

Rreth Imametit ne Kur'an

Edin Q. Lohja

Para se te flitet per ceshtjen e Imametit, e cila perben piken qe i ka ndare muslimanet ne dy shkolla te medha, duhet permendur fakti i rendesishem se Islami, si feja e fundit e zbritur per njerëzimin, besohet nga të gjithë muslimanët se është përsosja universale e mesazhit hyjnor. Ky universalitet i tij duhet ta ketë marrë parasysh faktin se ai do u drejtohej popujve, kulturave, natyrave dhe temperamenteve të ndryshme, duke ofruar mundësi interpretimi, brenda shpalljes, që do të integronin në perspektivën njësuere të Islamit lloje të ndryshme njerëzish në kohëra e hapësira të ndryshme. Kjo e bën krejtësisht të papranueshëm ekskluzivizmin e cilëso palë, pasi Islami është zbritur si fe e mëshirës dhe larmia e interpretimeve të tij mund të jetë dëshiruar vetëm nga Zoti.

Nga ana tjetër, Kur'ani Famelarte tregon se ata qe e fshehin te verteten, duke e ditur ate, mallkohen nga Allahu i Madheruar, meketet dhe te gjithë ata qe mallkojne (2:159). Si muslimane, jemi urdheruar per objektivitete, deshmim të drejte dhe qëndrim te paanshem për hir të Zotit dhe së vërtetës - kundër kujtdo qoftë ajo, dhe paçka se nuk do t'u pëlqejë të tjerëve - cilëtdo qofshin këta. Pra, ta themi te verteten edhe kur ajo eshte ne disfavorin tone, te afermve tane, te pasurve apo te varferve:

{O ju qe besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë (për hir) të Zotit, edhe nëse është kundër jush, kundër prindërve ose të afërmve tuaj, qoftë (kundër) pasanikut apo të varfrit ... të mos udhëhiqeni nga pasionet e t'i shmangeni drejtësisë!} (4:135)

{Kurdoherë që të flitni, jini të drejtë, edhe nëse është çështja për të afërmit!} (6:152)

{O ju që besuat, jini plotësisht të vendosur për hir të Zotit, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; jini të drejtë, sepse ajo është më pranë devotshmërisë!} (5:8)

{O ju besimtarë, përmbajuni mësimëve të Zotit dhe thuajini fjalët drejt!} (33:70)

Fshehja e se vertetes qortohet ashper ne Islam:

{dhe mos e mbuloni të vërtetën me të gënjeshtren e as mos e fshehni realitetin kur e dini!} (2:42)

{mos e mbuloni dëshminë, sepse kushdo që e fsheh atë, zemra e tij është e njollosur me mëkat} (2:283).

Allahu na i hapte syte dhe zemrat te pakten te shohim me kujdes e te gjykojme gjakftohetesisht! A nuk na ka urdheruar Ai ne Kur'anin Fisnik qe t'i verifikojme fjalet qe na vijne, per te shmangur hyrjen ne hak ndokujt:

{O ju që besuat, nëse një fasik ju sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojani mirë më parë, që përndryshe të mos i lëndoni të tjerët pa e ditur të vërtetën e më pas të pendoheni për çka vepruat} (49:6).

Tani, duke kaluar te tema jone, theksojme se, sipas ndjekesve te Ehl ul-Bejt, Imami

zgjidhet (caktohet) nga Allahu dhe emerohet nga Profeti (s) ose Imami paraprires e jo nga njerezit. Sipas tyre, Imameti perben kujdestarine e dijes se fese dhe udherrefimin e njerezve ne interpretimin e drejte te saj, si dhe vazhdimin e autoritetit te Profetit (s) mbi muslimanet, me perjashtimin se Imami, natyrisht, nuk merr shpallje: "Imameti eshte autoriteti universal ne te gjitha ceshtjet sekulare dhe fetare, si mekembes i Profetit (s)." (Alame Hili, *el-Hadi Bab ul-Ashar*, Londer: Luzac & Co., 1924, f. 62)

Pikëpamja e shi'izmit mbi prijësinë pra, mbështetet në konceptin e Imametit, një pozitë kjo që kombinon udhëheqjen shpirtërore-fetare dhe social-politike. Imami është zotërues i dijes ezoterike dhe ekzoterike, njohës i shkencave fetare dhe mbajtës i autoritetit udhëzues shpirtëror (wilajeh) që nuk varet nga (mos)patja e pushtetit prej tij: "Imameti dhe prijësia fetare në Islam mund të studiohen nga tre perspektiva: ajo e qeverisjes islame, e shkencave dhe urdhëresave islame, si dhe e udhëheqjes dhe udhërrëfimit inovativ në jetën shpirtërore. Shi'izmi beson se meqenëse shoqëria është në nevojë të thellë udhërrëfimi në të trija këto aspekte, personi që zë funksionin e dhënies së atij udhërrëfimi dhe është prijës i shoqërisë në këto lëmij me rëndësi fetare duhet caktuar nga Zoti dhe Profeti (s). Vetë Profeti (s) u caktua gjithashtu nga Urdhri Hyjnor." (Alame Tabataba'i, *Shi'ite Islam*, New York: SUNY Press, 1975, f. 173)

Profeti (s) kreu tre funksione themelore: ai veproi si mbartës dhe shpjegues i Shpalljes për njerëzimin, ishte sunduesi i bashkësisë islame duke zbatuar Ligjin Hyjnor e së fundi, ishte zotërues i ndriçimit dhe vizionit shpirtëror, duke mundur t'ua shpjegonte njerëzve kuptimin e brendshëm të Shpalljes dhe t'i udhëzonte ata në gradat e përsosjes shpirtërore.

Sipas sunnive, mëkëmbësi i Profetit (s) duhet të përmbushë vetëm një të njërin prej këtyre funksioneve, pra të zbatojë Sheri'atin: "Muslimanët s'mund t'ia dalin dot pa një Imam që do të merret me zbatimin e vendimeve të tyre, implementimin e kodit penal (Hudud), ruajtjen e kufijve të tyre, furnizimin e ushtrive të tyre, mbledhjen e zekatit të tyre, dënimin e grabitjeve dhe plaçkitjeve të kusarëve, mbajtjen e xhumave dhe hytbeve të Bajrameve, shuarjen e grindjeve mes njerëzve, marrjen e dëshmimeve për gjyqe, martimin e atyre që nuk kanë kujdestarë dhe ndarjen e presë së luftës." (Sa'd ud-Din et-Taftazani, *Sherh `Aka'idi'n-Nasafi*, Stamboll: 1326 H., f. 185)

Sunnitë gjithashtu pohojnë se Profeti (s) nuk kishte caktuar zëvendës gjatë jetës së tij. Kurse shi'itët mendojnë se mëkëmbësi i Profetit (s) duhet që jo vetëm të zbatojë Ligjin Hyjnor, por të zotërojë urti të ndriçuar nga Zoti dhe të jetë udhëheqës shpirtëror i njerëzve. Meqë ky funksion është dhunti e posaçme dhe nuk mund të gjykohej nga shumica e njerëzve, zëvendësi i Profetit duhet caktuar nga Allahu dhe emëruar nga i Dërguari (s). Shi'itët besojnë se Profeti (s) në fakt e caktoi `Aliun si khalif, për çka citojnë hadithe të shumta nga vetë burimet kanonike të sunnive, hadithe të cilat, sigurisht, interpretohen ndryshe nga këta të fundit.

Imameti nuk është ceshtje e lidhjes se gjakut e për pasojë nuk perben ofiq familjar qe trashegohet, sic pandehin disa te painformuar. Po te ishte ceshtje trashegimie, Imamet e Ehl ul-Bejtit do te kishin qene nga linja e Hasanit (r.a.) e jo ajo e Huseinit (r.a.) dhe ne tekstet shiite ekzistojne dhjetra hadithe qe tregojne se lidhja e gjakut me Profetin (s) nuk do u vlejte aspak pasardhesve te tij, por perkundrazi takwaja, adhurimet e shumta dhe veprat e mira. Shiitet e hedhin poshte fuqimisht trashegimin e autoritetit

[e cila filloi si dukuri me Mu'avijen], si nocion joislam dhe ngulmojne qe arsyeja pse Imamet duhet te jene nga Ehl ul-Bejti eshte se Vete Allahu i ka larteluar ata ne rangje te dijes e pershpirtshmerise, duke i pajisur me te kuptuarit e thelle dhe dhuntisur me virtyte te medha (sic deshmon vete Kur'ani dhe shume hadithe te percjella nga vete sunnite, te cilat mund te dokumentohen kollaj gjeresisht).

E verteta eshte se po te studiojme historine e te derguarve te Allahut, do te shohim se ata jane nga e njejta peme. Prijesia eshte caktuar nga Vete Allahu i Madheruar e Fuqiplote: {Dhe kur Ibrahim i u sprovua nga Zoti i tij me ca fjale, ai i permbushi ato. Atehere Ai tha: Vertet, po te caktoj Imam per njerezimin. (Ibrahimi) tha: Po nga pasardhesit e mi (a do te kete Imamë)? Ai tha: Marreveshja (zotimi) Ime nuk perfshin zullumqaret (nder ta)." (2:124)

Ne kete ajet fisnik, Allahu nuk ua mohoi prijesine (Imametin) pasardhesve te Ibrahimit (a.s.), por perkundrazi e kufizoi ate tek pasardhesit e tij te mirekualifikuar per kete pozite. Allahu premtonte se prijesia e caktuar hyjnerisht nuk do ta arrije personin qe eshte dhalim (zullumqar, padrejtesi-beres), madje edhe nese ai eshte pasardhes i Ibrahimit. Keshtu pra, te qenit pasardhes i Ibrahimit nuk e ben medoemos dhe automatikisht dike Imam, sepse ai duhet te kete cilesi dhe kualifikime shtese per kete. U kualifikuan per kete ata qe s'ishin zullumqare, keqberes, mekatberes, sepse jo vetem qe ishin te nje linje te paster, por i arriten ato nivele me mund e perpjekje te brendshme. Duke qene se Allahu kishte dije te perparme rreth durimit dhe cilesive te tyre, ai ua besoi atyre kete pozite, duke i preferuar mbi te gjitha te tjeret: {Pa dyshim, Allahu e preferoi (zgjedhi) Ademin e Nuhin dhe Familjen e Ibrahimit dhe Familjen e Imranit (mbi te gjitha) Krijesat} (3:33); {S'ka dyshim, Allahu e di më mirë ku e vendos mesazhin e Tij} (6:124).

Pema e Pejgamberit (s) shkon deri tek Ismaili (a.s.), i biri i Ibrahimit (a.s.). Po keshtu, Musai (a.s.) dhe Isai (a.s.) ishin qe te dy nga linja e Is'hakut (a.s.), djalit te dyte te Hz. Ibrahimit (a.s.). C'eshte e verteta, TE GJITHE te derguarit pas Ibrahimit (a.s.) ishin nga Al-i (pasardhja) i Ibrahimit [ndoshta s'e keni pyetur veten akoma qe pse muslimanet thone te pakten 5 here ne dite Allahumme sal-i ala Muhammed we ala al-i Muhammed, kemma salejte Ibrahim we ala al-i Ibrahim. Duhet pyetur ketu, se si u dashka ta bekoje Allahu pasardhjen e Muhammedit (s) mu ashtu sic e bekoji pasardhjen e Ibrahimit; si dhe perse te jete kaq e rendesishme kjo ceshtje sa te perfshihet ne namaz...?] Prapeseprape, shiitet nuk pohojne se profetesia duhet te jete e trasheguar, por se eshte Allahu ai qe i zgjedh ata, nje e nga nje, pra nuk thone se biri i nje profeti (ose imami kur diskutojme Imametin) duhet te jete gjithmone profet (imam ne rastin kur diskutojme Imametin), sepse duhen permbushur kualifikime te tjera shume te rendesishme shpirterore. Perndryshe Kanani, biri i Nuhit, do te kishte mbijetuar. Mirepo mbijetuan Aami, Sami dhe Jafasi, qe ishin nga nje nene tjetere me ate te Kananit. Pra lidhja e gjakut nuk e ben njeriun profet, imam e madje as te drejte e te perzotshem ne fe: ajo eshte e domosdoshme, sipas shiiteve, por jo e mjaftueshme.

Ne referim te ajetit: {O ju qe besuat, bindjuni Allahut dhe bindjuni Profetit e te ngarkuarve me autoritet mes jush} (4:59), shiitet, ashtu sikurse sunnite (shih psh Tefsirin e Imam Raziut per kete ajet) pohojne se urdhri per bindje ndaj Ulu'l-Amr eshte i pakushtezuar dhe per pasoje Ulu'l-Amr duhet te jene te pagabueshem ne ceshtje feje, pasi Allahu nuk mund te urdheroje bindje ndaj nje zullumqari, mekatberesi ose fasiku (shih 76:24 ku Allahu thote qarte {Mos iu bindni

mekatberesit}). Kesisoj, shi'itet i identifikojne Ulu'l-Amr pikerisht me Imamet e Ehl ul-Bejtin, bindja dhe te kapurit pas te cileve eshte urdheruar porsi bindja dhe te kapurit ndaj Kur'anit nga Profeti (s) dhe paraqitur si mbrojtje nga shkarja e humbja ne nje hadith mutewatir transmetuar nga se paku 39 sahabe, ne mbi 300 burime sunnite, ku i Derguari i Zotit (s) tha se linte dy gjera te cmuara me peshe (thekalejn): Kuranin dhe Ehl-i Bejtin. Kete hadith nuk e ka kundërshtuar as edhe nje njeri deri me sot dhe diskutimi mbi burimet e tij eshte teme me vete, e cila po ashtu dokumentohet gjere e gjate ekskluzivisht nga burime sunnite!

Arsye kryesore per kete identifikim te Ulu'l Amr me Imamet e Ehl ul-Bejtin eshte bindja se eshte Allahu ai qe zgjedh Imamet, ashtu sikurse zgjedh gjithcka tjeter:

{Dhe Zoti yt krijon ate qe deshiron dhe zgjedh; ata nuk kane te drejte te zgjedhin...} 28:68 apo {Dhe kur Allahu e i Derguari i Tij vendosin mbi nje ceshtje, nuk u takon as besimtareve e as besimtareve qe ne ate ceshtje te bejne nje zgjedhje te tyre} (33:36) etj etj.

Keshtu pra, te vazhdojme me ne fund me disa ajete mbi Imametin ne Kur'an:

{Vertet, Une do te bej (krijoj, vendos) nje kalif mbi toke} (2:30)

{O Davud, Ne te beme ty kalif mbi toke} (38:26)

{Dhe Ne i beme ata Imame, qe udhezojne sipas urdhrin Tone...} (21:73)

(Dhe Ne i beme ata Imame qe udhezojne me urdhrin Tone, kur u bene durimtare e ne shpalljet Tona fort besuan) (32:24)

Kur Musai iu lut Allahut: {Dhe bej nje vizir (mekembes) per mua nga Familja ima, Harunin, vellain tim...} (20:29-30) Ai iu pergjigj: {Vertet, tu plotesua lutja, o Davud} 20:36. Ketu nuk po u hyjme krahasimeve me hadithin e Pejgamberit (s) qe i tha Aliut: "Ti je per mua si Haruni per Musain, vecse nuk do te kete profet pas meje", burimet sunnite te te cilit nuk numerohen, duke qene se paku ne 100 zinxhire transmetimi.

{Dhe s'do te gjeni asnje ndryshim ne praktiken (ligjin) e Allahut} (33:62, etj)

Sipas shiiteve, Allahu i caktoi keta 12 Imame, jo vetem pse ishin nga Al-i Muhammed, por sepse, ne kohen e tyre, ishin me te diturit, me te ndriturit, me te frikesuarit para Zotit, me te virtytshmit dhe me te nderuarit tek Allahu dhe ne syte e muslimaneve [shihni psh pohimet e Imam Malikut ose Imam Ebu Hanifes per Xhafer es-Sadikun ose te Zuhriut per Zejn ul-Abidin etj]; dija e tyre ishte e percjelle nga njeri imam ne tjetrin nga Profeti (s) si dhe nga frymezimi (ilham) qe Vete Allahu ben ne zemrat e njerezve te devotshem. Madje vete burimet sunnite kane percjelle hadithe te sakta qe e cilesojne qarte se numri i khalifeve pas Profetit (s) do te jete 12, si: Buhariu, Muslimi, Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Ahmedi (nje fakt qe dokumentohet nga dhjetera referenca).

Me perjashtim te pasardhesve te profetit Muhammed (s), pasardhesit e profeteve te tjere ishin po ashtu profete, dhe kesisoj te caktuar nga Allahu. Kur'ani gjithashtu

tregon se disa profete, me urdhrin e Allahut, caktuan vete Imamet qe do i pasonin (te cilet nuk ishin profete). Psh:

{A s'i keni pare prijesis e beni Israileve pas Musait? Ata i thane nje profeti nga mesi i tyre: `Cakto per ne nje mbret qe te luftojme ne ceshtjen e Allahut.} (2:246)

Kushdo qe caktohet specifikisht nga Allahu si mbret, eshte Imam. Nje profet mund te jete gjithashtu Imam/mbret, por jo te gjithet profetet ishin Imame. Nese nje person i devotshem behet Imam/mbret, nuk pason medoemos qe ai te sundoje fizikisht. Ajeti i mesiperme flet per Talutin. Kurse ajeti ne vazhdim sqaron me tej:

{Pejgamberi i tyre (1) u tha atyre: `Allahu e ka caktuar Talutin si mbret (2) mbi ju.' Ata thane: `Si mund te na sundoje ai kur ne jemi me te pershtatshem se ai dhe atij nuk i edhe dhene pasuri e madhe? (3) Ai (pejgamberi i tyre) u tha: `Allahu e ka zgjedhur ate (4) permbi ju dhe e ka dhuntisur me dije te bollshme (5) e fuqi trupore; Allahu ia dhuron autoritetin e Vet kujt do Ai (6). Allahu kujdeset per gjithcka dhe di cdo gje} (2:247)

Pjesa (1) e ajetit tregon se bashkesia ne fjale kishte nje pejgamber dhe Taluti ishte pjesetar i asaj bashkiesie, keshtu qe pejgamberi i tyre ishte edhe pejgamberi i Talutit. Keshtu, Taluti vete nuk ishte pejgamber.

Pjesa (2) tregon se Allahu e caktoi talutin si Imam/prijes/mbret. Pjesa 3 tregon se mbreti i caktuar nga Zoti nuk zgjidhet ne baze te pasurise, por kryesith ne baze te pershpirtshmerise. Taluti sigurisht ishte me i denji per te sunduar edhe fizikisht, por ky sundim fizik varet ne njefare mase edhe nga bashkimi i njerezve ndaj sunduesit, nderkohe qe prijesia shpirtore paracaktohet per Imamin. Zgjedhja e Imamit/mbretit nuk eshte ceshtje e njerezve dhe, sikurse tregon pjesa 4 e ajetit Allahu e zgjedh Imamin/mbretin sepse Ai e di kush eshte me i denji per nje pozite te tille. Ketu mbret nenkupton personin qe ka autoritet nga Allahu, i cili, sic deshmon pjesa 5 eshte i mbushur me dije dhe urti.

Ne ajetin vijues kemi:

{Dhe pejgamberi i tyre u tha me tej: `Shenje e autoritetit te tij eshte se do t'ju vije juve Arka e Marreveshjes me sigurim nga Zoti juaj dhe reliket e lena nga Familja e Musait dhe Familja e Harunit, te mbartura nga meleket. Ketu ka shenja per ju, nese keni besim." (2:248)

Kurse ne nje ajet tjeter fisnik, Allahu i Madheruar thote:

{Apo mos ua kane zili njerezit per ate qe Allahu u ka dhene nga miresite e Tija? Por ne i kemi dhene Pasardhesve te Ibrahimit Librin dhe Urtine, e u kemi dhuruar mbreteri te madhe} 4:54

Kjo mbreteri (sovrانيت, autoritet) eshte Imameti, sepse fare pak nga Pasardhesit e Ibrahimit (a.s.) kane sunduar fizikisht!

Mirepo ketu ka pretendime se ne ato ajete ku termi është përdorur Imam ai nuk nenkupton me shume se nje prijës.

Pyesim: a mund te pohohet se Ibrahim (a.s.) ishte "jo me shume se nje prijës"? Is'haku, Ja'kubi? Davudi? Sulejmani? Taluti? Haruni, paqe paste mbi ta te gjithë? Apo pasardhësit e Ibrahimit deri ne kijamet? (shihni pak ajetin 43:28) Imam vertet dtht prijës, por prijës ne cka? Pikepamjen shiite se cfare nenkupton fjala prijës mund te shihet ne tefsir-ët shi'i, kurse ate sunnite ne tefsir-ët sunni. Secila shkolle ka pikepamjen e vet, me arsytet e forta perkatese, qe jane te dyja islame dhe te rrenjezuara thelle ne tradite.

Kurse pretendimit se shiitet ia veshin cdo permendje te fjales kalif apo imam nocionit te tyre te Imametit mund t'i pergjigjemi se nuk eshte tamam ashtu. Po te shfletohet vellimi i dyte i Tefsirit te njohur el-Mizan, nga 'Alame Tabataba'i, me i njohuri komentator ne shekkulin XX tek shiitet, ajeti 2:124 [Unë po te bej ty Imam...], do te shihet se nuk nenkuptohet kalifi, apo wasiu apo profeti me fjalen Imam, por pergjegjesi te tjera. Ja se cfare thuhet aty:

"Imameti nenkupton se dikush zoteron nje cilesi te brendshme, per shkak te se ciles njerezit duhet ta ndjekin ate me besnikeri, duke i bere fjalet dhe veprat e tyre konform me fjalet dhe veprat e tij; por asnje nga termat profet, khalif dhe wasi nuk e mbartin kete kuptim. [Kur Allahu i tha se do ta bente Imam] Ibrahim ishte tashme profet, bindja ndaj te cilit ishte e detyrueshme mbi njerezit. [Nese me Imam nenkuptohet profet] cfare kuptimi do te kishte t'i thuhej atij se Allahu do ta bente profet per njerezit? Ose, t'ua bente bindjen ndaj tij te detyrueshme ne gjithcka qe thonte e bente? Ose, kryetar i ummetit te tij per te urdheruar dhe ndaluar ne ceshtjet e fese? Ose trashegues (wasi)? Apo khalif ne toke per te gjykuar mes njerezve me urdhrin e Allahut?

Ndryshimi mes imametit dhe termave te siperpermendur nuk eshte vetem verbal; jane realitetet pas atyre fjaleve ato qe ndryshojne nga njeri tjetri. Kur dikujt i jepet profetesia, behet e detyrueshme per te gjithë njerezit qe t'i binden atij. Ndaj, do te ishte gabim t'i thuhej nje profeti: "Do ta bej bindjen ndaj teje te detyrueshme per njerezit megjithese e kam bere qe me perpara te detyrueshme." E as nuk do te ishte e sakte te percillej e njejta ide me fjale te tjera, sepse do te shfaqej i njejti problem. **KUR ALLAHU I JEP DIKUJ NJE POZITE, KY NJERI NUK MERR THJESHT NJE TITULL OSE EMER TE RI** [vini re, ne lidhje me pretendimin se me imam nenkuptohet thjesht 'prijës']: **BEKIMET E ALLAHUT NUK JANE FJALE BOSHE; EKZISTOJNE REALITETE TE CAKTUARA PAS ATYRE FJALEVE.** Ndaj, imameti ka realitetin e vet te posacem, te ndryshem nga realiteti i fjaleve te tjera.

Ne shohim qe sahere Kur'ani permend imametin, ai vendos udhezimin krak per krahe me te, saqe duket sikur Allahu e perdor kete te fundit per te shpjeguar te parin. Allahu thote ne ngjarjen e Ibrahimit: {Dhe Ne ia falem atij Is'hakun, e si dhurate te metejshe edhe Jakubin. Dhe qe te gjithë i beme te mire (te drejte); Dhe i beme imamë (a'immeten) qe udhezoin sipas urdhrin Tone...} (21:72-73) dhe ne nje vend tjetër: {Dhe prej tyre beme imame qe me urdhrin Tone te udhezojne, pasi ata ishin te durueshem dhe ndaj argumenteve Tona krejt te sigurte} (32:24). Ketu imameti shpjegohet, ose me mire – perkufizohet, ne terma te udhezimit, dhe kualifikohet me tej nga provizoja: {me urdhrin Tone}. Eshte e qarte pra, se imameti nuk dtht cfaredolloj udhezimi e prijësie [vini re!], ai eshte nje udherrefim qe buron nga urdhri i Allahut (shih 36:82-83, 54:50 per kuptimin e 'urdhrit te Allahut')...

...Per ta permbledhur, Imam eshte nje prijës qe udhezoi me Urdhrin Hyjnor, i cili eshte i lidhur ngusht me te. [vini re, vella, ne lidhje me objeksionin tuaj per Imam in e kohes:] Imamet, ne kuptimin e tij ezoterik (te brendshem) eshte el-wilajeh (udheheqje/autoritet) mbi njerezit ne veprat e veprimtarite e tyre; udherrefimi i siguruar prej tij kerkon çuarjen e njerezve ne cakun e tyre perfundimtar, me Urdhrin e Allahut [vini re perseri se cila eshte pergjegjesia e Imamit ne lidhje me ate nese ka apo nuk ka dobi nga Imami i fshehur, me poshte ne pyetjen tuaj]. Ai dallon nga udherrefimi i cili vetem tregon rrugen – dhe i cili zakonisht behet nga peygamberet dhe te derguarit e Allahut, si dhe nga besimtarete e tjere qe i udhezoi njerezit drejt Tij me fjale te sinqerte e keshille te mire [shih 16:125]. Ky lloj i dyte i udherrefimit permendet ne ajetet 14:4, 40:38, 9:122 etj.

Pastaj Allahu pershkruan arsyen perse ua dha atyre imamet: {sepse ishin te durueshem dhe ndaj argumenteve Tona krejt te sigurte} (32:24). Kriteret pra, jane durimi e siguria (jekin) absolute. Ata ishin te devotshem dhe durimtare ne ceshtjen e Allahut. Durimi, ne kete ajet, eshte i pakushtezuar, ndaj dhe nenkupton te qenit te durueshem e te devotshem ne te gjitha ceshtjet dhe kushtet, me te cilat Allahu mund te zgjedhe ta sprovede nenshtrimin e robit te Vet. Dhe ata zoteronin shkallen me te larte te sigurise. Duke shqyrtuar ngjarjet e Ibrahimit (a.s.), shohim fjalet e Allahut: {Dhe keshtu ia treguam atij mbreterine e qiejve dhe te tokes, qe ai te ishte nga ata te sigurtit (palekundurit)} (6:75) Ky ajet shpalos qarte se të treguarit e mbreterise se tille Ibrahimit (a.s.) ishte preludi i dhurimit te sigurise absolute per ate. Ai verteton se siguria (jekin) eshte nje shoqerues i pandashem i te shikuarit te mbreterise. Kjo eshte edhe tema e ajeteve:

{Sikur ta dinit me nje dije te sigurte (ilm ul-jekin), ju mesiguri do ta shihnit xhehenemin} 102:5-6

{Jo, nuk eshte ashtu! Por te keqijate qe benin ua kane mbuluar zemrat. Jo pra! Ate dite do te jene te penguar prej Zotit te tyre... Jo (nuk jane njelloj). Se libri i te mireve do te jete ne Ilijjinë. E ku e di ti se cka eshte Ilijjinë? Ai eshte nje liber i qendisur qarte, qe e deshmojne ata me te afertit (te Allahut)} (83:14-15 dhe 18-21)

Keto ajete vertetojne se "te afertit" jane ata qe nuk jane te penguar nga Zoti i tyre; ne zemrat e tyre nuk ka ndryshk ose shtresa mekati, paditurie ose dyshimi; ata jane qe kane siguri absolute per Allahun, dhe ata e shohin Ilijjinin sikurse shohin xhehenemin.

Me nje fjale, eshte esenciale per nje Imam qe te jete njeri me siguri te plote, cili e sheh boten e "mbreterise" se Allahut, qe mbeshtetet ne "fjalet" e Allahut. Me lart kemi shpjeguar se mbreteria eshte urdhri i Allahut, qe nga ana e vet eshte ana ezoterike e universit.

Le t'i bejme nje rishikim te fresket ajetit 21:73 (dhe 32:24) cituar me lart: {Dhe Ne i beme Imame, qe te udhezoi (njerezit) me urdhrin Tone}. Ai verteton shume qarte se cilido qofte subjekti i udherrefimit (pra zemrat dhe veprat), Imami ia zoteron atij realitetin e brendshem; ai eshte ne kontakt te pareshtur me anen tjetere te tij, anen e urdhrin, e cila nuk eshte kurre e fshehur prej tij. Dihet se zemrat dhe veprat, sikurse cdo gje tjetere, kane dy ane: nje ate te "urdhrit" e tjetren ate te "krijimit". Prandaj,

realiteti i veprave te njerezve – si te mirave, ashtu edhe te keqijave – eshte gjithmone perbrenda vizionit te Imamit, nen vezhginim e tij te paprere; dhe ai ka autoritet mbi te dyja rruget: ate te gezimit e shkelqimit dhe ate te moslumturise e trishtimit. Po ashtu, Allahu thote: {(Perkujto) ditën kur do të therrasim cdo popull me Imamin e tyre} (17:71). Keshtu pra, Imami eshte ai qe do t'i udheheqe njerezit drejt Allahut {ditën kur gjerat e fshehta do të shpalosen}, PASI AI I UDHEHEQ ATA DREJT ZOTIT NE JETET EKZOTERIKE (dhahir) DHE EZOTERIKE (batin) TE KESAJ BOTE. Ajeti 17:71 tregon gjithashtu se nuk mund te kete asnje periudhe, as edhe nje cast, pa nje Imam, sepse Allahu thote {cdo popull} [shihni zberthimin e ketij ajeti ne vellimin perkates, ku vertetohet se me Imam nuk nenkuptohet libri i veprave, sic mendojne disa]

Imameti eshte nje pozite aq e lartësuar dhe sublime saqe nuk mund t'i jepet askujt, pervec atij qe eshte jashtezakonisht i virtytshem ne vetvete. Nese shpirti i tij eshte i ndotur, qofte edhe ne shkalle fare te vogel, me ndonje padrejtesi ose mekat, atehere ai ka nevojë per dike tjeter qe ta udhezonte serish ne rrugë te drejte. Dhe Allahu ka thene: {A eshte me i denje te ndiqet ai qe udhezonte tek e Verteta, apo ai qe nuk ecen ne rrugë te drejte, veç nese udhezohet prej dikuj tjeter?} (10:35) Ketu Allahu vendos dy grupe perballe njeri tjetrit: (i) ai qe udhezonte tek e verteta dhe (ii) ai qe nuk ecen ne rrugë te drejte, vec nese udhezohet prej dikuj tjetri, apo me fjale te tjera, ai qe ka nevojë per ndihme per t'u udhezuar ne te drejte. Ky kontrast d.t.th. se ai qe udhezonte per tek e verteta eshte ne vetvete i udhezuar, kurse ai qe udhezohet nga nje person tjeter nuk mund te udhezonte per tek e verteta.

Nga diskutimi i mesiperme vijon se:

Se pari, Imami duhet te jete ma'sum (i pamekate, i mbrojtur nga mekati). Perndryshe, ai nuk do te ishte vete i udhezuar, sic u shpjegua me lart. Gjithashtu, ajeti vijues verteton pamekatesine (el-`ismeh) e tyre: {Dhe ata i beme Imamë qe udhezonin me urdhrin Tone, dhe i orientuam ne berjen e veprave te mira, faljen e namazit dhe dhenien e zekatit, dhe ata ishin adhures Tane te sinqerte} (21:73). Sipas ketij ajeti, te gjitha veprat e Imamit jane te mira, ai udhezohet (orientohet) per tek ato, jo nga ndokush tjeter, por vetiu me ndihmen Hyjnore. Faza e perkthyer si "berjen e veprave te mira" eshte fi'la`l-khajrat (te besh vepra te mira); ajo eshte el-masdar (forme paskajore) e perdorur si konstrukt i pare i nje konstruktit ne rase gjinore; dhe nje masdar i tille verteton se veprimi ka ndodhur me siguri. Me fjale te tjera: Sikur Allahu te kishte thene: `Ne i orientuam ata: beni vepra te mira!" kjo nuk do te kishte treguar se ata ne te vertete iu binden urdhrin dhe bene vepra te mira; mirepo kur Ai thote: {Ne i orientuam ata ne berjen e veprave te mira} ajo dth se gjithcka qe ata bene ishte nepermjet frymezimit Hyjnor dhe ndihmes qiellore.

Se dyti, ai qe nuk eshte ma'sum nuk mund te jete kurre Imam, pra udhezues per tek e verteta. Tani, eshte e qarte se mbiemri "zullumqaret" ne ajetin {Marreveshja Ime nuk do te perfshije zullumqaret} (2:124) mbulon kedo qe mund te kete bere cfaredo lloj padrejtesie, zullumi (dhulm), psh politeizem, idhujtari ose cfaredolloj mekati tjeter, ne cilendo periudhe te jetes se tij, edhe sikur te jete penduar dhe te jete bere i mire me pas.

Fakti se nga ky ajet rrjedh qe Imami duhet te jete patjeter ma'sum mund te vertetohet keshtu:

Logjikisht, mund t'i ndajme njerezit ne kater grupe: (1) Ai qe mbetet i padrejte (zullumqar - dhalim) pergjate gjithë jetes se tij; (2) ai qe nuk ka qene asnjehere dhalim gjate tere jetes se vet (3) Ai qe ka qene i padrejte ne fillim, po eshte bere i drejte me pas; dhe (4) Ai qe ishte i drejte ne fillim por u be i padrejte me pas.

Ibrahimi (a.s) ishte teper sublim ne pozite per te kerkuar imamet per njerez qe do futeshein ne grupin e pare ose te katert. Mbeten dy mundesi (e dyta dhe e treta), per t'u perfshire ne lutjen e tij. Dhe Allahu e kundershtoi njerin prej tyre: ata qe ishin te padrejte ne fillim por u bene te drejte me pas. Keshtu, mbetet vetem nje grup, te cilit mund t'i jepet imameti: ai qe nuk ka qene i padrejte ne asnje periudhe te jetes se tij; pra ai qe eshte ma'sum.

Per ta permbledhur, ky ajet tregon se:

1. Imameti eshte nje pozite e dhuruar nga Zoti. [vini re, se nuk behet fjale serish per cfaredolloj prijesie e as per khilafet ne kuptimin e Ehl-i Sunnetit].
2. Imami duhet te jete ma'sum, nepermjet `ismeh-tit te dhuruar nga Zoti. Me fjale te tjera, ai duhet te jete i mbrojtur nga Allahu prej gabimeve dhe mekateve.
3. Toka nuk mund te jete pa nje Imam, per sa kohe te kete njerez mbi te. [vini re!]
4. Eshte thelbesore per nje Imam qe te mbeshtetet nga ndihma Hyjnore.
5. Vepra e njerezve nuk jane te fshehura nga Imami.
6. Imami duhet te zoteroje dije per gjithcka qe nevojitet per te miren e njerezve ne kete bote dhe ne tjetren [vini re dhe referojuni pjeses ku diskutohet ajeti 10:35]
7. Eshte e pamundur per cilindo person bashkekohes te tij qe t'ia kaloje Imamit ne cilendo prej virtyteve. Keta shtate jane nga faktoret themelore te imametit, dhe ky ajet, i lexuar perkrah ajeteve te tjera relevante, na shpie drejt tyre, dhe Allahu eshte Udherrefyesi yne." (fund i citatit nga tefsiri i 'Alame Tabataba'it)

Tani shpesh shtrohet pyetja se si udhëhiqen shiitet nga Imam i tanishëm duke qene se ai eshte ne ghajbet (fshehje) dhe ku qendron perkryeshmeria e tij?

Kesaj i pergjigjemi se nga citimi me lart se autori i nderuar e sqaroi kete vetem nga ato ajete qe citoi, por ka ajete te tjera, shume me eksplicite per perkryeshmerine e Imameve nga Ehl-i Bejti, si psh 33:33, 4:59 si dhe hadithe qe urdherojne kapjen e pakushtezuar pas Kur'anit dhe Ehl-i Bejtit, dy gjera me peshe keto qe, sipas hadithit te ndershem profetik, nuk do t'i lene muslimanet te rreshqasin kurre dhe per me teper nuk do te ndahen nga njera tjetra gjersa ta takojne Pejgamberin tek Haudi i Keutherit, Diten e Gjykimit. Kjo do te thote se ne asnje kohe (e as sot pra, shihni edhe nje here komentin e autorit, ajetin 17:71 dhe sidomos 43:28) nuk do te mungoje nje perfaqesues nga Ehl-i Bejti, Imami, qe t'i udhezoi njerezit duke qene i pandashem nga Kur'ani, dmth duke urdheruar perkryeshmerisht ne perputhje te plote me urdheresat e Librit te Allahut. Nuk ka asnje njeri ne historine e ummetit qe ta kete kundershuar kete hadith profetik, te percjelle mutewatir nga te pakten 39 sahabe ne

mbi 300 vepra te Ehl-i Sunnetit: "Po le me ju dy gjera te cmuara me peshe (thekalejn), te cilave po t'u permbaheni, nuk do ju lenë kurre qe te shmangeni pas meje: Librin e Allahut dhe Ehl-i Bejtin tim. Ato nuk do te ndahen gjersa te me takojne tek Haudi i Keutherit."

Ne dime gjithashtu se Profetin (s) dhe ditën e gjykimit e ndajne shume shekuj, e megjithate ai ka thene se khalifet, emiret, apo imamet do te jene vetem 12 pas tij! Burimet e ketij hadithi nuk numerohen dhe ai ndodhet tek Buhariu, Muslimi, Ahmedi, Ebu Davudi, Tirmidhiu e dhjetere te tjere...

Lidhur me nevojën e ekzistences se nje Imami te pgabueshe, si tregues i drejtesise se Allahut pohojme se lart sapo u tregua qe kjo eshte domosdoshmeri kur'anore dhe hadithore gjithashtu. Per te qene me te sakte, shiitet nuk thone se eshte drejtesi ('adl) e Zotit, por butesi, miresi (*lutf*) i Tij. Pra Zoti, nga butesia, miresia, delikatesa e Tij, nuk i le pa udherrefim njerezit dhe ua siguron atyre burimin e pagabueshem te udhezimit, te cilit t'i referohen pa frike a medyshje mbi saktesine e opinionit te tij, sepse ai eshte interpretuesi i sakte i fese (sikurse pohohet edhe ne hadithe te tjera eksplicite ne vete burimet sunnite qe nuk po i permend per te mos u zgjatur shume).

Nese dikush pyet se si ka mundesi te udheheqe nje njeri qe eshte me se 1000 vjec do te pergjigjeshim: Cfare ka te papranueshme ketu? A pranohen/kundershtohen gjerat ne baze te te dukurit te tyre te cuditshme apo ne baze te argumenteve? Sic u pa me lart, karakteristikat udherreyese te Imamit jane dhunti nga Allahu, jo merite personale qe ai e ka ne dore te vet. Keshtu edhe jetegjatesia e tij, pohojne shiitet, eshte dhurate e Allahut, per te Cilin asgje nuk eshte e pamundur, sepse Ai eshte i Gjithpushtetshmi, Fuqiploti. Ndaj as mosha e madhe e Imam Mehdiut nuk eshte merite e Imam Mehdiut, por dhunti nga Allahu, me arsyet e saja te thella. A nuk jetoj Nuhi (a.s.) mes popullit te tij per 950 vjet (shih Kur'anin, 29:14)? Ne hadithe transmetohet se ai ka jetuar deri 3000 vjet. A nuk eshte Isa (a.s.) - edhe me i vjeter se Mehdiu - i gjalle, tek Zoti i tij? Po Hz. Khidri a s'eshte i gjalle akoma dhe ne toke madje? Ne muslimanet besojme ne shume gjera, qe arsyen se zakonshme mund t'i duken te cuditshme, por kjo nuk i ben assesi te papranueshme, sepse shpallja eshte burim superior i dijes, mbi arsyen e kufizuar njerezore.. Ja vetem disa shembuj, asnjeri prej te cileve nuk mund te ndodhet vetiu, por vetem me lejen e Allahut, sigurisht:

Ne si muslimane, i besojme Allahun te Lartesuar kur pohon ne Kur'an se nje njeri kaloi prane nje fshati e tha me vete: "Si mund ta rigjalleroje Allahu kete toke te vdekur?" Allahu e vuri ate ne gjume per 100 vjet dhe pastaj e riktheu ne jete. Per me teper, Allahu e kishte lene ushqimin e njeriut TE PAPREKUR per 100 vjet!! Atehere Allahu i tha atij qe ta veshtronte gomarin dhe te shihte se si e kthente ate ne jete Allahu, duke ia ribashkuar kockat dhe mbuluar ato me mish. Kur e pa kete skene, njeriu tha: "Tani e di me siguri se Allahu (swt) eshte vertet i Gjithfuqishem dhe Fuqiplote per cdo gje."

Ne si muslimane i besojme Allahut (swt) kur thote ne Kur'an se Ibrahim (a.s.) i ndau zogjte ne copa dhe ua shperndau pjeset neper male dhe pastaj i thirri ato pjese e zogjte filluan te fluturonin me lejen e Allahut!!!

Ne si muslimane, i besojme Allahut kur Ai pohon ne Kur'anin Besnik se zjarri i pergatitur nga jobesimtarete u be i ftohte per Ibrahim (a.s.)!!!

Ne si muslimane i besojme Allahut (swt) kur thote ne Kur'an se Isai (a.s.) lindi pa baba, me lejen e Allahut!! Ne po ashtu besojme se ai nuk ka vdekur dhe se do te kthehet ne toke kur te deshiroje Allahu!!!

Ne si muslimane i besojme Allahut (swt) kur ai tregon ne Kur'an se Isai (a.s.) i ringjallte te vdekurit, me lejen e Allahut, dhe se sheronte te semuret, te verberit dhe te tjeret!!!

Ne si muslimane i besojme Allahut xh.sh. kur Ai thote ne Kur'an se shkopi i Musait u kthye ne gjarper!!! Dhe po ashtu besojme se oqeani u nda me dysh per t'ua mundesuar Beni Israileve kalimin e sigurt dhe per t'i ikur persekutimit te Faraonit!!!

Ne si muslimane i besojme Allahut kur ai pohon ne Kur'an se lumi Nil u kthye ne gjak me lejen e Allahut!!!

Ne si muslimane i besojme Allahut xhsh kur Ai tregon ne Kur'an se Sulejmani (a.s.) e kuptonte gjuhen e zogjve dhe fliste me ta si dhe me thneglat dhe xhinnet; dhe se mbreteria e tij (a.s.) mund te fluturonte ne ajer; dhe se mbreteria e Mbretereshes Belkise iu soll atij sa hap e mbyll syte, te gjitha me lejen e Allahut.

Ne si muslimane i besojme Allahut xh.sh. kur tregon ne Kur'an se as'habi kahf u vune ne vdekje per 309 vjet afersisht dhe pastaj u ringjallen me lejen e Allahut!!!

Ne si muslimane i besojme Allahut kur Ai pohon ne Kur'an se Hz. Khidri eshte i gjalle dhe se e takoi Musain (a.s.) kur ishin ne anije se bashku, me lejen e Allahut!!

Ne si muslimane i besojme Allahut xh.sh. kur tregon ne Kur'an se Ademi u lind pa nene dhe pa baba!!!

Dhe keto te gjitha nuk mund te vertetohen ose hidhen poshte shkencerisht, logjikisht, apo edhe simbolikisht madje; prape se prape si muslimane ne na kerkohet t'i pranojme dhe te besojme ne to. Shiitet poojne qe: si mund te kundershohet nocioni i Mehdiut atehere, kur ata thone se jetezgjatja e tij eshte gjithashtu me lejen dhe dhuntine e Allahut, e jo me meriten e tij?

Shpesh pyetet me tej se si mund te udhëhiqesh kur Imami nuk është i pranishëm dhe i disponueshm fizikisht.

Krahas faktit se kjo u sqarua ne komentin e Tabataba'it, e njejta pyetje iu drejtua njehere Xha'fer es-Sadikut, Imamit te gjashte nga Ehl-i Bejti. Ai u pergjigj: "Si mund te ngrohesh nga dielli kur ai s'eshte i shikueshem? Kur ndodhet pas reve, ju nuk mund ta shikoni, por a mund ta mohoni?"

Terheqim verejtjen ndaj kuptimit shpirtor te udhezimit qe perfshin Imameti: nuk eshte fjala per udheheqje ushtarake, administruese etj... Shihni komentin e Tabataba'it dhe shenimet per nevojen e prijesise ne tre sferat.

Objeksionit se asnjeri nuk ka kontakt direkt me Imam Mehdiun gjate ghajbetit i pergjigjemi se eshte i vertete sa i perket fjales direkt, por natyra e udhezimit eshte

shpirtërore në këto etape të gënjëtit dhe kontakti shpirtëror s'është i mbyllur për askënd, aq më tepër që dijetarët me të thelluar e kanë kontaktin me Imam Mehdiun, sipas shiiteve, në nivel të drejtëpërdrejtë shpirtëror, jo fizik.

Nëse pretendohet që për pasoje të moskontaktit fizik me Mehdiun situata e shiiteve është e njëjte me atë të sunnive, do të ishte keqkuptim qesharak i asaj që është thënë tashmë mbi Imametin. Mjafton t'u hedhesh një sy punimeve klasike të teoricienëve të shquar sunni mbi sundimin (*mulk*) në Islam, si psh el-Mawardi, Nizam el-Mulk, et-Taftazani, Ibn Khaldun etj dhe do ta hihni se teoria sunnite e pushtetit është krejt tjetër me atë shiite, e cila ka ngjyrim thellësisht fetar, nderkohe që ajo sunnite ka ngjyrim administrues, politik, mbrojtës të Ligjit (Sheriatit), ku sunduesi nuk është aspak medoemos dijetar dhe njohës i realiteteve të brendshme të fese, etj...

Shiitet, gjatë fshehjes (okultacionit - gënjëbëh) të Imam Mehdiut, drejtohen në ASPEKTIN FETAR e jo atë politik nga dijetarët e hadithit dhe fikh-ut, dhe kjo shihet qartë në shumë e shumë transmetime shiite nga vete Imamet, që ua ngarkuan ndjekësve të tyre t'u drejtohen dijetarëve të hadithit dhe fikh-ut, në mosprani të Imameve, si dhe në epokën e gënjëtit (fshehjes) të madh të Imam Mehdiut. Me lejoni të percjell dy prej tyre:

Transmetohet nga Imam Xhafer es-Sadiku (Imami i gjashtë i Ehl-i Bejtit) dhe Imam Hasan el-`Askeriu (Imami i 11-te, babai i Imam Mehdiut) se gjatë periudhës së gënjëtit: "Njerëzit e kanë për detyrë të ndjekin atë fekih që i rri larg mëkatit, mbron fenë, mposht dëshirat e egos dhe i bindet Zotit të vet." (et-Tabarsi, el- Ihtixhaxh, Nexhef: Mensuret ul-Nu'man, 1387/1966, vëll. II, f. 263; el-`Amili, Wesa'il ush-Shi`a, Beirut: Dar Ihja et-Turath el-Islami, 1391/1970, vëll. XVIII, f. 29).

Kështu, pra roli i udhëheqjes së jashtme, formale, rri mbi shpatullat e muxhtehideve shiite, kurse ai i brendshëm shpirtëror është në përgjegjësinë dhe arritjen e Imamit të kohës, Mehdiut. Sikurse pohon Muhammed Rida el-Mudhaffer (1904-1968), një dijetar i shquar i prominencës shiite të shek. XX:

"Në besojmë se një muxhtehid krejtësisht i kualifikuar është përfaqësues i Imamit, në mosprani të këtij. Kësisoj, ai është autoritet mbi muslimanët dhe kryen funksionet e Imamit lidhur me gjykimet dhe administrimin mes tyre. Për këtë arsye, Imam Sadiku ka thënë:

'Mohimi i autoritetit të muxhtehid-it është mohim i autoritetit të Imamit dhe mohimi i autoritetit të Imamit do të thotë kundërshtim i autoritetit të Allahut, që është baras me politeizëm (shirk).'

Prandaj, muxhtehid-i i kualifikuar jo vetëm që jep verdikte ligjore (fetwa), por ai gjithashtu ka autoritet të përgjithshëm mbi muslimanët, që duhet ta konsultojnë atë nëse kërkojnë gjykim, ku kjo është e arritshme vetëm prej tij. Për pasoje, është e gabuar për këdo që të gjykojë përveç atij, ose dikujt të caktuar prej tij, pasi askush nuk mund të japë vendim pa lejen e tij. Po ashtu, gjithë çka i takon Imamit, i duhet dhënë muxhtehid-it.

Një autoritet i tillë i është dhuruar muxhtehid-it të kualifikuar nga Imami, në mënyrë që ai ta përfaqësojë Imamin në mungesë; prandaj ai njihet si përfaqësues i Imamit

(na'ib ul-Imam)." (Aka'id ul-Imamije, Nexhef, 1961, f. 6 - perkthyer ne anglisht, spanjisht, italisht, shqip dhe shume gjuhe te tjera..)

Gjithashtu nje nder keqkuptimet me te medha per menyren e prijesisimit tek shiitet eshte se ata nuk kishin sistem udhëheqës deri ne revolucionin iranian. Mirepo kjo vjen nga mendimet e shume njerezve te painformuar, te cileve nga nje keqkuptim i madh dhe propaganda e disa qarqeve te caktuara iu eshte krijuar pershtypja se ka shenje barazie mes Iranit dhe shiizmit, shiizmi nenkuptoka Iranin dhe anasjelltas. Kur dihet se iranianet perbejne maksimumi 30% te shiiteve ne bote! Dhe se ka patur udhëheqje per shiitet edhe para 1979-es.

Keshtu ne cdo kohe, tek shiitet ekziston muxhtehidi me i shquar i kohes (qe quhet marxha et-teklid) per ta (sepse, ndryshe nga sunnite qe ia kane mbyllur dyert ixhtihadit tash 1100 vjet, shiizmi ka nje tradite te panderprere dhe te fresket te ixhtihadit nga brezi ne brez dhe ixhtihadi nuk eshte monopol i askujt dhe as nuk kufizohet dot ne aksh veta). Keshtu, psh ne vitet 40-60 te shek te kaluar ka qene Ajetullah Buruxherdiu, nje njeri apolitik dhe i perzotshem, per te cilin Aj. Khomeini thoshte: "Ai eshte nje luan i pergjumur, shkundeni!" duke dashur ta angazhonte ne jeten publike dhe politike me teper... Nga 1962, kur vdiq Aj. Buruxherdiu deri me 1970 ka qene marxha et-teklid Ajetullah Muhsin el-Hakim nga Iraku.

Pastaj ka pasur disa muxhtehide, asnjeri prej te cileve nuk eshte shquar ne menyre absolute. Psh ne Irak keni patur el-Khoin, kurse ne Iran Khomeinin, ku i pari ishte per mosperzierje ne politike, kurse i dyti per angazhim ne fatet e kombit dhe njerezve ne menyre me direkte! Sot ka 5-6 te tille, ku asnjeri nuk shquhet tamam, por nder me te ndjekurit jane Ajetullah Sistani ne Irak dhe 2-3 te tjere ne Iran.

Kurse sistemi i vilajeti fekih i cili momentalisht sundon ne Iran eshte i krijuar nga zberthimi i disa tezave te Khomeinit mbi autoritetin e fekihut (juristit islam), bazuar mbi idete e tij per problemet e Iranit te viteve 50-70 te shekullit te kaluar, si reagim ndaj te cilave ai u perpoq te krijonte nje qasje islame. Duhet theksuar se ai nuk perben aspak me teper se nje interpretim vetjak te nje dietari te respektuar shiit dhe nuk eshte teze mbareshiite, madje as ne vete Iranin, ku ka debate te medha e shume te thella mbi kete ceshtje dhe nje numer dietarësh nuk pajtohen me *velajet-i fekih-un*.

Dijetaret kompetente nuk zgjidhen ne kuptimin e rendomte, ata shquhen me dijen e tyre dhe behen, si te thuash, te imponueshem nga respekti qe krijojne, sipas kriterëve te mesiperme qe citova nga librat shiite. Ata nuk 'zgjidhen' nga njerezit, sic pretendojne ata qe thone se kjo eshte nje situatë e njejte me cfare ndodhi ne Sekifen e fisit Beni Saide.

Kjo nuk mund te quhe e njejta gje. Ne radhe te pare Hz Ebu Bekri r.a. nuk u zgjodh nga masa, por vetem nga 2 muhaxhire qe shkuan me te tek Sakifa e Bani Saides, dhe nja 15 ensare qe ishin mbledhur atje per te zgjedhur khalifin (!) nga mesi i ensareve. Ebu Bekri r.a. u APROVUA nga masa me pas, ku thuajse te gjithë ia dhane atij betimin, por nuk eshte se gjithë masa MORI PJESE NE ZGJEDHJE. Madje masa as qe e dinte se po mbahej nje zgjedhje ne Sakife, sepse Ebu Bekri r.a., Umeri r.a. dhe Ebu Ubejde ibn ul-Xherrah r.a. kishin shkuar atje me nxitim pasi ishin njoftuar nga nje sahab tjetër, nderkohe qe masa ishte e shokuar nga kalimi i Profetit (s) dhe familja e tij me Aliun ne krye po kujdeseshin per ritet e varrimit. Aq sa, vete Ebu Bekri

(r.a.) e konsideroi ate lloj zgjedhjeje [qe ishte nje improvizim, i motivuar nga shqetesimi i tij per t'ia dale me situaten emergjente te krijuar] si "shkarje, nga demet e se ciles na mbrojti Allahu" dhe po keshtu mendonte edhe Hz. Umeri me pas.

Vetë Ebu Bekri r.a. deklaroi se bejati që kishte marrë nuk ishte kryer në përputhje me ixhma'në. Ai e pohoi këtë kur mbajti një fjalim në agimet e khilafetit të tij, ku i tha mases: "Bejati që kam marrë është një shkarje e nxituar, nga e keqja e së cilës na mbrojti Allahu dhe pati parandjenjë për fitne." (e citon Ebu Bekr Ahmed ibn `Abdul-`Aziz el-Xheuheri; në librin e tij el-Sakife). `Umeri r.a. e dëshmoi po këtë fakt, para shumë njerëzve, kur mbajti një hytbe nga minberi i Xhamisë së Profetit (s) një xhuma, pak para përfundimit të khilafetit të tij. Buhariu e ka përfshirë në Sahih, (kreu mbi gurosjen e gruas që martohet pasi mbetet shtatzënë nga zinaja, f. 119, vëll. IV). Ai citohet po ashtu edhe nga shumë muhadithë e historianë si Ibn Xherir Taberiu, tek shtjellimi i ngjarjeve të vitit 11 H. në Tarikh, dhe une po jua citoj këtu shprehimisht fjalet e Hz. Umerit (r.a.):

"Kam marrë vesh se dikush [ky dikush ishte Abdullah Ibn Zubeiri r.a. dhe fjalët e tija kishin qenë: "Wallahi! Porsa `Umeri të vdesë, do ia jap betimin `Aliut, sepse bejati ndaj Ebu Bekrit ishte një rrëshqitje nga ummeti, e cila kaloi pa trazime." Për këtë arsye, `Umeri u zemërua në skaj dhe mbajti fjalimin. Kjo pohohet nga shumë prej atyre që e kanë komentuar Buhariun. Drejtojuni shpjegimit të këtij hadithi në Sherhun e Kastalaniut, f. 352, vëll. XI, dhe ju do ta shihni autorin duke cituar Baladhuriun lidhur me mbiemrat, dhe pranuar vërtetësinë e këtij hadithi sipas kritereve të që të dy Shejhëve] ka thënë që nëse `Umeri vdes, ai do t'i japë betimin fulanit; atëherë, le të mos ngurrojë kush së thëni se bejati i dhënë Ebu Bekrit r.a. ishte një shkarje (felt) që u krye, sepse qe pikërisht e tillë, por Allahu na mbrojti nga e keqja e pasojave të saj... Kushdo që i jep bejatin dikujt pa u konsultuar më parë me të tjerët, duke e bërë këtë vetëm nga frika se do të vritej nëse s'do ta bënte, atëherë ai nuk duhet ta bëjë aspak atë [dhe le të pranojë vdekjen më mirë]... Një nga fjalët që qarkulluan për ne kur Allahu e mori të Dërguarin e Tij (s) nga ne ishte se ensarët dalluan prej nesh në qëndrimet e tyre; ata të gjithë u mblodhën në sakifen e Beni Sa`ides; krahas tyre `Aliu, Zubeiri dhe ndjekësit e tyre, dalluan gjithashtu..."

Pohimi i perseritur i Hz. Umerit r.a. se "Dhënia e betimit ndaj Ebu Bekrit ishte një shkarje (ne arabisht *felt*) nga e keqja e të cilës na mbroi Allahu; prandaj, duhet ta vrisni këdo që e përsërit." u bë jashtëzakonisht i famshëm e shumë historianë e kanë transmetuar. Psh Bukhariu në Sahih, vëll. VIII. ff. 210, 211; el-Kastalani në Sherh ul-Buhari, vëll. XI, f. 352; Ahmedi në Musned, vëll. 1, f. 55; Taberiu në Tarikh, vëll. 1, f. 1822; Ibn ul-`Athiri në el-Kamil fi Tarikh, vëll. II, f. 327; Ibn Kethiri në el-Bidaje we'n-Nihaje, vëll. V, f. 246; Ibn Hishami në Sire, vëll. IV, f. 308-9; Sujutiu në Tarikh ul-Khulefa', f. 60; Halebiu në Sire, vëll. III, ff. 388, 392; Baladhuriu në Ansab ul-Ashraf, vëll. V, f. 15; Bakilaniu në Temhid, f. 196 etj.

Ai vazhdoi të theksonte atë që kishte ndodhur te veranda [sakife], debatet dhe dallimet e opinionit, zërat që u ngritën nga merakosja për sigurinë e fesë, etj. Pikërisht nën këto rrethana ia dha `Umeri bejat-in Ebu Bekrit.